



Prishtinë, 28 janar 2016
Kodi i ZRRE-së: V_765_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-604-2013 të datës 27 dhjetor 2013 se shoqëria "AIR -ENERGY" SH.P.K., ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga Era, me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, në lokacionin "Wind Park-KITKA", Komuna e Kamenicës; dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, në lokacionin WindPark - Kitka, me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, komuna e Kamenicës, të datës 07.12.2015, të shoqërisë "AIR - ENERGY" SH.P.K., me adresë "Isa Boletini", p.n. Komuna Gjilan, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2016 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_604_2013 i datës 27 dhjetor 2013, lëshuar shoqërisë "AIR - ENERGY" SH.P.K., edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht **deri me 27 qershor 2016**.

A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 25.09.2013 nga shoqëria "AIR ENERGY" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, në lokacionin WindPark - Kitka, me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, komuna e Kamenicës.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Era, me datë 27 dhjetor 2013 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_604_2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- o Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqëria "AIR ENERGY" SH.P.K., do t'i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me



Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.


- Shoqëria **"AIR ENERGY" SH.P.K.**, në kërkesën e saj ka sqaruar se: pas pranimit të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nga ZRRE, ne menjëherë kemi filluar me përgatitjet për kompletimin e dokumentacionit për marrjen e Lejes së Ndërtimit. Aplikimi është bërë me datë 20.03.2013 për vazhdimin e lejes së ndërtimit pas që projekti i tillë ka pasur leje të ndërtimit të lëshuar me datë 07.12.2009. Mirëpo pas konsultimit me MMPH, konkretisht me Departamentin e Urbanizmit është thënë se "ligjërisht nuk mund të vazhdohet leja ekzistuese e ndërtimit pas që ka kaluar afati ligjin, dhe duhet të aplikohet nga fillimi për leje të ndërtimit".
 - Ka sqaruar se me ligjin e ri të Ndërtimit, fillimisht kërkohet të aplikohet për kushte Urbanistike në MMPH/Departamentin për Planifikim Hapësinor, dhe janë kompletuar dokumentacioni i nevojshëm ku me datë 16.07.2014, është aplikuar për Kushte Ndërtimore. Ndërkohë nga Ministria Përkatëse janë njoftuar se ligji për kushte ndërtimore ka ndryshuar dhe duhet përsëri të aplikohet dhe të përgatitet projekti i ri sipas kushteve të ligjit tani në fuqi. Kështu ka sqaruar se përsëri janë detyruar të përgatisin të gjitha dokumentet dhe projektet sipas ligjit në fuqi, ku me datë 02.06.2015 janë plotësuar të gjitha lejet, pëlqimet dhe projektet sipas shtojcës 2 për kërkesa paraprake për kushte ndërtimore për projekte të kategorisë së III.
 - Shoqëria në fjalë ka sqaruar se pas kërkesave të vazhdueshme për shpejtimin e procedurave duke përfshirë edhe vizitat në teren dhe lajmërimi për debat publik për të gjithë të interesuarit, ku me datë 11.11.2015 është mbajtur edhe Debati Publik pran Departamentit për Planifikim Mjedisor me palët e interesit për projektin energjetik, pjesëmarrës të gjithë akterët institucional. Pas kësaj projekti sipas procedurave ligjore është vendosur në konsultim publik për një muaj gjegjësisht deri me datë 11.12.2015, ku pas kësaj pritet të lëshohen Kushtet Urbanistike dhe pastaj të aplikohet për leje ndërtimore. Andaj, në bazë të këtyre rrethanave dhe vonesave të shkaktuara nga MMPH-ja, shoqëria është detyruar të kërkojë shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-604-2013 të datës 27 dhjetor 2015 edhe për gjashtë (6) muaj sipas procedurave në fuqi. (bashkangjitur dokumentacionin për aplikim për leje ndërtimore pran MMPH-së).
 - ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar ato dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Shoqëria **"AIR ENERGY" SH.P.K.**, brenda këtij afati duhet të bëjë kërkesë me shkrim, për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, në lokacionin WindPark - Kitka, me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, Komuna e Kamenicës, gjegjësisht deri me datën **27 qershor 2016** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- III. Pas skadimit të afatit të cekur në dispozitivin e vendimit, Vendimi V-604-2013 i datës 27 dhjetor 2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, **do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.**
- IV. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.





V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar